

Newsletter 1-2016

Retrospektivë!

Duke skanuar vitin 2016!

Rellinghauser Str. 22
45128 Essen

Tel.: + 49 (20 1) 75 99 85 28
Fax: + 49 (20 1) 75 99 85 29
E-Mail: info@i-de-al.org
Web: www.i-de-al.org

Amtsgericht: Essen VR 5251
Steuernr.: 112/5870/1294

Bankverbindung: Volksbank
IBAN DE19301602130038378015

Präsidentin: Anduena Stephan
Vertretung: Alban Shehu

Të dashur Anëtarë të **IDEAL**, të dashur miq,

Viti 2016 ishte një vit i mbushur me ngjarje dhe aktivitete për ne dhe miqtë tanë.

Aktivitetet të këtij viti nisën më 1 shkurt me praktikantët e punës për nxënësin e klasës së tetë të gjimnazit **Joel Stephan**, për t'u pasuar nga studentja e ekonomikut të Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Bochold, **Florentina Buzhala** (Mars-Qershor), më pas punonjësja e parlamentit të Shqipërisë **Zhaklina Dharmo** e cila ishte gjatë muajit Maj në parlamentin e Landit, nxënësen e klasës së 10-të nga Münster **Stelina Novaku** në Korrik, me studenten e Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Kleve **Ketrina Ajazi** nga Shtatori e deri në Dhjetor. Kjo ishte hera e parë që **IDEAL** në bashkëpunim të ngushtë me **Konsullatën e Nderit** dhe **bizneset lokale** u krijoi mundësinë të rinjve nga **diaspora**, por dhe nga Shqipëria për të patur mundësinë të komunikojnë dhe të bëheshin **pjesë e rrjetit të madh** të **IDEAL**. Kjo eksperiencë e shkëlqyer pritet të përsëritet sërish në **vitin 2017**.



Shqipëria dhe arti i saj si pjesëz e rrjetës së stërmadhe të artit botëror nuk e ka të lehtë të gjejë vendin e saj të merituar dhe të rrugëtojë e të bëhet e prekshme jashtë kufijve të saj. Arti shqiptar ka ambasadorë të heshtur, por kërkues, që e ngrenë atë lart dhe e rrisin në peshë: shqiptarët e çdo ane të globit.

Me mbështetjen proaktive të **Ministritsë së Kulturës** së Republikës së Shqipërisë, **Ministritsë së Kulturës** së Landit të NRW, **Konsullatës së Nderit** të Shqipërisë në NRW, **Ambasadës së Republikës** së Shqipërisë në Berlin, **Galerisë Kombëtare** të Arteve të Shqipërisë, **Drejtorisë së Kulturës** së qytetit të Düsseldorfit dhe Shoqatës Integrative Gjermano- Shqiptare – **IDEAL**, më **8 Mars**, talenti i ri **Eros Dibra** paraqiti punimet e para të tij të krijuara në kuadrin e programit „Artist in Residence“ në qytetin e Düsseldorfit.

Eros ishte **bursist i Ministritsë së Kulturës të Landit** Nordrhein-Westfalen. Një juri gjermane e zgjodhi atë mes shumë kandidatësh të tjerë dhe i dha mundësinë e një qëndrimi 2-mujor në ateljenë e qytetit të Düsseldorfit. **Ekspozita qendroi e hapur nga 10 - deri në datën 24 mars.**

Me ftesë të **Europa-Union Geilenkirchen**, kryetari i këtij unioni **Prof. Gerd Wassenberg** dhe kryebashkiaku **Georg Schmitz** ftuan më **18 Mars** në ambjentet e bashkisë së qytetit **ambasadorin** e Republikës së Shqipërisë si dhe presidenten e **IDEAL**, njëkohësisht Konsulle e Nderit të Shqipërisë në NRW **Anduena Stephan**. Republika e Shqipërisë dhe Republika Federale e Gjermanisë dëshirojnë të thellojnë bashkëpunimin kulturor edhe në kontekstin evropian. Në këtë mënyrë **përforcohet bashkëpunimi** universitar, mësimi i gjuhës, bashkëpunimi në fushat e sporteve dhe rinisë, ruajtja e monumenteve si dhe bashkëpunimi mes profesionistëve të



institucioneve kulturore dhe shkencore.

Krahas Zonjës Stephan, **IDEAL** u paraqit edhe me violinisten dhjetë vjeçare **Debora Berliku**, e cila për katër vite rradhazi ka marrë çmimin e parë në konkursin “**Jugend musiziert**” organizuar nga qyteti i Essen sëbashku me njëmbëdhjetë vjeçarin Michael Koschewatsky (piano). Një aktivitet i tillë i projektuar me dashuri si dhe me shumë të pranishëm mbush çdo shqiptar me gëzim të veçantë, sidomos kur **fokusi kryesor** përqendrohet te ngjallja e **interesit për kulturën dhe vendin tonë**.



Me iniciativën e Konsullatës së Nderit të Shqipërisë në Gjermani (NRW), IDEAL, përfaqësuar nga zyra në Bruksel nën kryesinë e Znj. **Silva Reka**, me mbështetjen e **ambasadave shqiptare dhe kosovare në Bruksel dhe Berlin**, nisi një dialog i hapur dhe shumë konstruktiv rreth së ardhmes së Shqipërisë dhe Kosovës, parë nga **perspektiva e qytetarëve shqiptarë në BE** me anëtarët e Parlamentit Evropian, të cilët vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Landi i Nordrhein Westfalen.



Anduena Stephan, Megi Maas, Silva Reka dhe Anila Dervishi vunë themelet e një ure lidhëse e bashkëpunimi me Znj. **Monika Hohlmeier** kryetaren e grupit “Friends of Albania” në Parlamentin European, Znj. **Susanne Melior**, Dr. **Renate Sommer**, Znj. **Petra Kammerevert**, respektivisht anëtare dhe zëvendësanëtare e delegacionit European për Shqipërinë, si dhe me Znj. Victoria Priker, anëtare e kabinetit të Znj. **Ulrike Lunacek**, zëvendës-presidente e Bashkimit Evropian, me Znj. **Blerta Hoti**, këshilltare politike e Delegacionit suedez, dhe me deputetët e qytetit të Essen në Parlamentin e BE-së, **Z. Jens Geier**. Ato morën iniciativën për të themeluar **Forumit e parë Evropian të Gruas Shqiptare në diasporë**, me bazë në Bruksel-Belgjikë si dhe Essen-Gjermani.



Forumi është konceptuar si një rrjet i hapur komunikimi me fokus Evropën dhe do të vihet në zbatim nëpërmjet personave të kontaktit në **Gjermani, Itali, Francë, Austri, Angli, Greqi, Suedi, vendet e Beneluksit, Zvicër, Kosovë dhe Shqipëri.**

Në 21-13 shtator 2016 Ambasadori Kuko vizitoi Köln, Essen dhe Düsseldorf për të zhvilluar takime të rëndësishme së bashku me **Konsullin e Nderit të Shqipërisë dhe Presidenten e IDEAL Znj. Anduena Stephan**, me Sekretarin e Shtetit në Ministrinë për Çështjet Evropiane dhe Federale **Dr. Eumann**, Ministrin e Drejtësisë **Z. Thomas Kutschaty** si dhe me **diasporën** për të prezantuar platformën elektronike të procesimit të çështjeve konsullore dhe për të ftuar diasporën e NRW në **Samitin e parë të Diasporës** në Tiranë. Në ambientet e **IDEAL** u zhvillua një takim shumë konstruktiv me shumë përfaqësues të shoqatave e të diasporës.

Për herë të parë në sallën qendrore të **Muzeut Kombëtar** në Tiranë **shtatë artistë të njohur të qytetit të Dyseldorf** paraqitën punimet e tyre në fotografi moderne dhe instalacion. Ekspozita „**ZOOM - 7x Düsseldorf Fotografie**“ u hap më **14.10 dhe qendroi deri më 31.10.2016**. Të gjithë të një brezi dhe të hapur për një ndërveprim dhe ndërkomunikim me publikun artdashës të Shqipërisë, artistët e shoqërojnë vetë ekspozitën dhe e kthejnë në pjesë të punës së tyre.

Vendosja e kësaj ekspozite në hollin qendror të Muzeut Kombëtar në Tiranë pati gjithashtu një simbolikë të veçantë. Edhe ekspozita vetë ishte si **një rrugëtim mes historish dhe fatesh njerëzore** në vende të ndryshme dhe kohë të ndryshme. Kjo ekspozitë e organizuar nga **IDEAL** nën patronazhin e **Konsullatës së Nderit të Shqipërisë** në NRW dhe mundësuar nga **Zyra e Kulturës së Dyseldorf dhe Ministria e Kulturës e Shqipërisë** në kuadrin e



Tetorit Gjerman 2016, do të hapë rrugët për më shumë shkëmbime të këtij niveli në të ardhmen.

Më 18-20 nëntor 2016 u zhvillua **Samiti i parë i Diasporës** në Tiranë. Ky Samit mbledhi për herë të parë, pa dallime politike, prejardhje gjeografike dhe brezi rreth 1000 përfaqësues të shoqatave të ndryshme Shqiptare, personalitete të shquara si dhe pjesmarrës të thjeshtë e bashkëkombas nga e gjithë bota, me qëllim formimin e një ure të përbashkët bashkëpunimi për të siguruar komunikim dhe ndërveprim, si dhe forcimin e marrëdhënieve mes diasporës, atdheut dhe komuniteteve. **IDEAL** u përfaqësua nga Znj. Stephan, Znj. Reka dhe Znj. Kelmendi.

Por Nëntori Shqiptar shënoi kulmin e tij më **27 nëntor** pasi ceremonia festive e kësaj dite u hap me veshjen e Maneken Pis me kostumin kombëtar shqiptar. **IDEAL** u ftua nga ambasada e Shqipërisë në Bruksel dhe mori pjesë si në festimet e organizuara nga shoqata simotër Vatra në Belgjikë ashtu dhe në pritjen tradicionale të Ambasadës Shqiptare të kryeqytetit të Evropës. Rreth 300 të ftuar ishin pjesë e këtij eventi.

IDEAL ju mirëpret si anëtarë apo si dashamirës të kombit dhe përparimit! **Së bashku arrijmë më shumë.** Për më shumë informacione mbi ne na vizitoni në **www.i-de-al.org**.

Ejani me ne të tregojmë **vlerat tona, kulturën dhe vitalitetin tonë!**

Mirësevini!

IDEAL -isht juaji



Aneksi 1

Literturë Shqiptare në Bibliotekën e Essen-it

Ne gjuhën shqipe

Libra për Fëmijë

- Bushaka, Gaqo: Përrallat e shiut
- Bushaka, Gaqo: Çufoja dhe Bubi Kaçurrel
- Bushaka, Gaqo: Pushimet e Çufos
- Bushaka, Gaqo: Filmi i gjeneral Çufos
- Bushaka, Gaqo: Çufo president
- Grillo, Odhise K.: Lahuta e Malsisë

Romane

- Blushi, Ben: Otello, Arapi i Vlorës
- Blushi, Ben: Të jetosh në ishull
- Bulka, Nonda: Fabula në prozë
- Çajupi, Andon Zako: Vepra dramaturgjike
- De Rada, Jeronim: Këngët e Milosaos
- Zejno, Krenar: Këmba e të panjohurës

Publicistike

- Çabej, Eqrem: Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes
- Çabej, Eqrem: Diana dhe zana
- Cika-Kelmendi, Mimoza: Kosova si çështje europiane
- Cika-Kelmendi, Mimoza: Kadare ndryshe
- Ngjela, Spartak: Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare
- Fevziu, Blendi: Enver Hoxha
- Kule, Virgjil: Gjergj Kastrioti Skënderbeu „Kryqtari i fundit“
- Pllumi, Zef: Saga e fëmijnisë
- Çabej, Eqrem: Hyrje në indoeuropianistikë

DVDs

- Virgjil Kule: Ionian romance [DVD]
- Virgjil Kule: Romance joniane [DVD]

Libra të Autorëve Shqiptarë në Gjermanisht

Romane und Publicistik

- Ahmeti, Mimoza: **Milchkuss**
- Ferra, Ilir: **Rauchschatten**
- Kadaré, Helena: **Eine Frau aus Tirana**
- Kongoli, Fatos: **Die albanische Braut**
- Kongoli, Fatos: **Hundehaut**
- Mustafaj, Besnik: **Kleine Saga aus dem Kerker**
- Ornela Vorpsi, Ornela: **Die Hand, die man nicht beißt**
- **Si dhe koleksioni i plote i veprave te Ismail Kadare**